

Njoftim për Përqendrim me të cilin Shoqëria Aksionare për Ndërmjetësim të Sigurimeve VFP SHA Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, do të fitojë kontroll të vetëm mbi Shtëpinë Ndërmjetësuese INOVO BROKER SHA Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

(Lënda nr. 08-154 /2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe (“Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24), më datë 21.11.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftimi për Përqendrim, i cili ka të bëjë me fitimin e kontrollit të vetëm nga Shoqëria Aksionare për Ndërmjetësim të Sigurimeve VFP SHA Shkup, me seli në Bul. Koço Racin nr. 3, hyrja 2, kati 2, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, mbi Shtëpinë Ndërmjetësuese INOVO BROKER SHA Shkup, me seli në Bul. Teodosij Gologanov nr. 60-1, kati 2, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së aksioneve.

Shoqëria Aksionare për Ndërmjetësim të Sigurimeve VFP SHA Shkup është pjesë e grupit këshillues financiar WVP Group of Graz, Republika e Austrisë. Grupi VFP është një pionier në fushën e shërbimeve të avancuara financiare, i përfaqësuar në fushën e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Grupi u themelua në vitin 1985, në Graz, Republika e Austrisë. Aktiviteti prioritar i Grupit VFP është ndërmjetësimi dhe shitja e produkteve të sigurimit dhe financiare në 15 vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore për më shumë se 30 vjet. Përveç R. së Austrisë, grupi është i pranishëm edhe përmes personave juridikë në R. e Bosnjë-Hercegovinës, R. e Bullgarisë, R. e Kroacisë, R. e Ukrainës, R. e Moldavisë, Republika e Serbisë, R. Mali i Zi, R. Shqipërisë, si dhe R. Maqedonia e Veriut.

Shoqëria Aksionare për Ndërmjetësim të Sigurimeve VFP SHA Shkup është një nga personat juridikë që janë pjesë e Grupit VFP. Ajo është themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 16.05. 2005, dhe në përputhje me rregulloret ligjore ka licencë për kryerjen e aktiviteteve nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aksionari më i madh i kompanisë VFP AD Shkup është WVP-Versicherungs-Vermittlungs - Ges.mbH, R. Austria, e cila zotëron 77.85% të aksioneve të VFP SHA Shkup. Veprimtaria kryesore e kompanisë lidhet me aktivitetet e agjentëve të sigurimit dhe ndërmjetësve të sigurimit në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shtëpia Ndërmjetësuese INOVO BROKER SHA Shkup është anëtar i Bursës së Maqedonisë SHA Shkup dhe Depozituesit Qendror të Letrave me Vlerë SHA Shkup. Ajo është themeluar më 24 tetor 2005 dhe është e autorizuar të tregtojë letra me vlerë në bursën e Maqedonisë. Aktiviteti prioritar i INOVO BROKER janë aktivitetet ndërmjetësuese në funksionimin e kontratave të letrave me vlerë dhe mallrave. INOVO BROKER kryen punë për blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë me porosi dhe në llogari të klientëve, vepron si mbrojtës gjatë kuotimeve, merret me konsulencën e investimeve, si dhe marrjen dhe transferimin e porosive për blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë në tregjet e huaja të letrave me vlerë

Pas shqyrtimit paraprak, Komisioni ka përcaktuar se Përqendrimi i propozuar mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet ende i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

25.11. 2024

Shkup